



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani i Elezit

01/Nr.4486 /2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 pika c, 34, 40, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 2008/08, për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 12, 15, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Hanit të Elezit neni 15 shkronja (a), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.09.2012 mori:

**VENDIM
PËR**

**PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA
VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT**

I

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet rregullorja për Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra Vendbanime dhe Lagje Urbane në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit e aprovuar nga Kuvendi i Komunës më datë 08.12.2010.

II

Rregullorja për Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra Vendbanime dhe Lagje Urbane në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit përmban 17 nene dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

Më hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja me numër 01/Nr.175/2010 e datës 08.12.2010.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

V

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Administratë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:27.09.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Mënduh Vlashi

